



Republika e Kosovës

Republika Kosovo
Republic of Kosovo



Kuvendi i Komunës Istog

Skupština Opštine Istok
Municipal Assembly Istog

Komiteti për Politikë dhe Financa/Komitet za Politiku i Financije/ Policy and Finance Committee

Nr. 06	P r o c e s v e r b a l
Tipi i mbledhjes:	Mbledhje e Rregullt e KPF-së
Data e mbajtjes:	15.09.2022 në ora 14:00
Mbledhjen e kryesoi:	Enver Rugova, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Istogut dhe
Procesmbajtës:	Vjosa Hysenaj, Zyrtare e Lartë për Punë Profesionale të Kuvendit të Komunës së Istogut
Pjesëmarrës anëtarët e KPF-së	Hajrush Shoshi, Faruk Kabashi, Liridona Lajqi, Ardita Idrizaj, Ajshe Metaj dhe Niman Begiraj
Mungojnë:	
Pjesëmarrës të tjerë:	Kryetari i Komunës z. Ilir Ferati, Nënkryetari i Komunës Ali Nimanaj, Agim Ademaj, Drejtorat: Merita Muzliaj Bytyçi, Elianë Blakaj, Agon Dreshaj, Dukagjin Hoxhaj, Zenel Shatri, Naim Behluli, Abedin Kabashi, zyrtar Administrativ: Jeta Balaj, Alketa Bujupi Bytyçi, Flora Bujupi, Ardon Arifaj, OSCE Hysen Pelaj, Alferd Tahirsylaj.
Rendi i ditës: - Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar; - Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt Rregullores për ndarjen e bursave, - Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës së KRM "Ambienti" njësia operative Istog, për ngritjen e çmimit të shërbimit të grumbullimit, transportit dhe deponimit të mbeturinave, - Shqyrtimi dhe miratimi i Draft Buxhetit për vitin 2023-2025. - Miratimi i Transferit të mjeteve buxhetore të mbetura për bartje nga Kategoria Ekonomike 38-Rezerva në Kategorinë Ekonomike,30-Shpenzime Kapitale në shumë prej-400,000.00€. - Shqyrtimi dhe Miratimi i projektit të ri kapital në bashkëfinancim me komunitetin për projektin "Ndërtimi I rrugëve në lagjen Osmanaj në Prekallë dhe Lagjen Blakaj në Llukavc të Begut" në vlerë prej 14,000.00 euro pjesa. - Shqyrtimi dhe miratimi i Bartjes së mjeteve buxhetore të mbetura në vlerë prej: 12,987.00 €, nga viti 2019, 2020 nga të hyrat vetanake të pa shpenzuara në vitin 2022, - Shqyrtimi dhe miratimi i propozim vendimit për destinimit të pronave të paluajtshme të komunës për aktivitete sportive.	

Diskutimet:

Kryesuesi i Kuvendit z. Enver Rugova, përshëndeti të pranishmit.

Konstaton të gjithë anëtarët e KPF-së janë prezent, kushtet janë plotësuar për mbajtjen e kësaj mbledhje.

Hapë punimet për këtë mbledhje me pikat e rendit të ditës të parapara për këtë mbledhje.

Prezanton rendin e ditës,

Fton Ekzekutivin si dhe Anëtarët e KPF-së nëse dikush ka ndonjë pyetje sugjerim apo ndonjë propozim për rend dite?

Kryetari i Komunës z. Ilir Fetati – përshëndet të gjithë të pranishmit, propozon një pika për rend dite,

1. Ndërrimi i emrit të projektit “Drenazhimi i fushës së sportit Demush Mavraj” me emrin e ri të projektit “Ndërtimi i Murit Rrethues të Stadiumit Demush Maraj.

Hedh në votim kush është për

miratohet unanim nga anëtarët e KPF-së që kjo pikë të hy në rend dite.

Vazhdojmë me miratimin e rendit të ditës.

Kush është që të miratohet rendi i ditës.

Miratohet rendi i ditës unanim nga anëtarët e KPF-së.

Prezent në mbledhje janë të gjithë anëtarët e Komitetit

Vendimet:

Miratohet me shumicë votash rendi i ditës, me këtë propozim nga Kryetari i Komunës.

Personat përgjegjës për zbatim: Shërbimi për punë të kuvendit

Afati për zbatim: Deri në mbledhjen e kuvendit

Shqyrtimi i pikës 1.**Diskutimet:**

Kryesuesi, vazhdojmë më pikën e rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar, a ka dikush diçka?

Ajshe Metaj – përshëndet të gjithë të pranishmit, në proces nuk është shënuar diskutimi jonë vetë çka është miratuar konstatimet.

Kryesuesi i Kuvendit – e dimi Ajshe por incizim nuk ka pasur dhe po është problem me i përcjell të gjithë fjalimin tuaj. Kam biseduar me sekretarin disa here rreth procesverbaleve por nuk ka staf edhe po është problem.

Niman Beqiraj - përshëndet të gjithë të pranishmit, pasi që incizim nuk ka kish qenë mirë që të paktën disa nga pikat kryesore të përmenden, ne e kemi lenë që procesverbali të mos shkruhet të gjitha

diskutimet por disa le të shënohen.

Ajshe Metaj – të shkruhet koncepti i diskutimit, sepse kështu si mos me fol hiq.

Kryesuesi i Kuvendit - Hedh në votim.

Procesverbali miratohet me 5 vota për dhe 2 kundër

Vendimet:

Personat përgjegjës për zbatim:

Shërbimi për punë të kuvendit

Afati për zbatim:

Shërbimi për punë të kuvendit

Shqyrtimi i pikës 2.

Diskutimet:

Kryesuesi i Kuvendit, vazhdojmë më pikën e dytë të rendit të ditës: Shqyrtimi dhe miratimi i Projekt Rregullores për ndarjen e bursave,

Drejtori për Arsimit z. Naim Behlulaj – përshëndet të gjithë të pranishmit, prezanton dhe sqaron Projekt Rregullores për ndarjen e bursave.

Niman Beqiraj – kam një vërejtje apo sqarim si ta them me kontribut diçka në shumën 700 euro për bursë, kjo shumë me nuk e ka vlerën si e ka pas edhe për shkak të inflacionit 20% që po flitet që është inflacioni mundet të jetë edhe me ndryshe kish qenë mirë mos me e caktuar si shumë po me e bere një analizë se sa i duhen një studenti e vendos çmimin.

Të shtohet edhe një kriter shtesë tek prindërit e zhdukur në luftë si dhe largësia 0.5 për kilometër në fakt ne jemi në Istog dhe largësia me fshatra nuk është e madhe. Nuk është kriter që do të duhej të vlerësohej studenti në këtë drejtim, mendoj që është kriter i tepërt.

Kryetari i Komunës – është ndarë një shumë e caktuar e buxhetit për pjesën e dytë të dhenjes së bursave sepse pjesa e parë u është ndarë dhe në kuvend aty ke qen edhe ti ku kemi planifikuar këtë shumë është për njëqind me e madhe për në të kaluarën a kanë qenë mundësin buxhetore të komunës. Në vitet në vijim do ta shikojmë se çka mund të planifikojmë.

Naim Belulaj – ne sa i përket shumës e kemi bere një ngritje se jemi munduat pak a shumë me i plotësuar kriteret edhe kushtet e studenteve të cilët janë duke i vazhduar studimet nga 600 kemi arritur në 700 euro ndërsa kriteri që u përmend 0.5 kilometra është shkolla profesionale për shkolla të mesme. Ndërsa sa i përket familjeve të zhdukurve ne kemi këtë kriter në bazë të ligjit që është.

Niman Beqiraj – 700 euro sot e kanë vlerën e 560 euro me herët nëse ja heqim 20% për afërsisht. E të kriteri unë e paskam keqkuptuar.

Ajshe Metaj – të ndahen me drejtime dhe dhenja e bursave, mësues po kemi mjaftë drejtimi i Edukimit nuk ka vend këtu, jo se dua ta nënçmoj profesionin tim por ka mjaftueshëm me edukim dhe nuk po ka vende pune.

Naim Behlulaj - këtu kei pasur për qellim me i përfshi fakultetet te cilat janë hy, por me shumë ju

kemi kushtet vëmendje gjinisë femërore që janë duke shkuar në këtë fakultet dhe me ju dhen me shumë përparësi.

Nevojat e komunës i kemi vendosur poshtë, pasi që e kemi bërë një hulumtim.

Kryetari i Komunës - fakulteti i shkencave natyrore matematik, fizik dhe kimi, a po flasim për studentët të këtyre drejtimeve apo po flasim për nxënës të FSHMN-së.

Naim Behlulaj - për student deficitar të këtyre drejtimeve fizik, kimi ,matematik.

Kryetari i Komunës - në këto drejtime nuk ka pasur konkurrent neper konkurse është dashur të thirren privatisht ku kemi ditur që ka e këto drejtime apsuventa, në kimi ka qen vetëm një kandidat.

Hajrush Shoshi - përshëndet të gjithë të pranishmit , kam disa vërejtje të cilat mund ti diskutojmë këtu. Të neni 2 një gabim teknik, neni 2 prape te bursave shuma e caktuar që komuna i jep një studenti mendoj se nuk është definicioni i duhur mendoj se nuk duhet të jetë shumë bursa nuk është shumë assesi të bëhet mbështetje financiare për studentet që fitojnë të drejtën për tu financuar që e merr një bursë.

Neni 3 lexon nenin te specifikohet qe kush ka drejt me aplikuar për bursë sepse mund të vij një student që studion jashtë vendit të aplikoj dhe ka të drejt.

Të ndarja e buxhetit për bursa duhet të ndahet një pik e veçantë, të ndahen me përqindje 75% për student nëse janë të ndara 50 mije euro po e marr shembull, të ndahen me përqindje të caktuar për student, për nxënës dhe për bursa ndërkombëtare. Kështu i lehtësohet puna komisionit. Kriteret për vlerësim të bursave për nxënës (lexon nenin) të përcaktohet nota mesatare sepse çdo dëftesa e ka notën mesatare neni 8 pika1.1 kërkohet një vërtetim për gjendjen socio ekonomike të nxënësit vlerësohet me 15 pikë, nuk e di cili do të jetë aj vërtetim, kush do ta lëshoj atë vërtetim. Të orientohemi ti japim bursa nxënësve - studentëve të cilët kanë nevojë, që nuk kanë kushte të vijnë studimet edhe këtë vërtetim e kisha hjekë.

Të kriteret e bursave për student (lexon nenin) por të ngjashëm kemi nenin ____ pika 1.5 prapë figuron e njëjta studentet nga familja e ngushtë e invalidit të luftës, duhet të hiqet se po perseritet. Të ndahen veteranet dhe viktimat civile nuk janë të barabartë të ndahen veteranet me nga 5 pike viktimat civile me nga 5 pikë. Pikët sipas notës mesatare të hiqen krejt. A do ta nxjerrim një notë mesatare apo ti lemë të gjithë me konkurrue, ku studentet me nota mesatare 6 nuk ka shanc të marr bursë pse po i krijon shpenzime me aplikuar duhet të hiqet kriteri i notës mesatare.

Neni 12 vlerësimi i kushteve pika 3 (lexon piken) komisionit nuk duhet ti lihen duar e lira që të formoj nen kritere, të gjitha kriteret duhet të përcaktohen në Rregullore. Pika 10 (lexon piken) të hiqet paragrafi 1.4 .

Naim Behlulaj - të neni 8 është bere një gabim teknik, nota mesatare të shkolla e mesme, të familjet e dëshmorëve e këto kategori që janë të dala nga lufta është ligji të i cili na obligon që ta zbatoj, të nota mesatare jam konsultuar me ekspertet e Ministrisë së Arsimit, dhe me kanë sugjeruar mos të përcaktohet nota mesatare. Të gjitha ndryshimet që i përmende do ti shqyrtojmë me komisionin dhe do vendoset, që kjo Rregullore të jetë sa me funksionale.

Ajshe Metaj - fakulteti i shkencave matematiko natyrore është lëmi e veçante, fakulteti i edukimit është tjetër këtë diferencë dua të sqarohem. Edhe pse infermiera është përjashtuar nga përfitimi i

bursës.

Kryetari i Komunës - pajtohem me mendimin e profesoreshës që fakulteti i edukimit nuk është deficitar. Edhe të Hajrushit që komisioni mos të ketë të drejtë të qesë nën kritere. Të gjitha këto propozime të vendosen në kriteret e Rregullores.

Naim Behlulaj - sa i përket infermieres nuk është deficitare sepse kemi shumë të pa punë.

Kryesuesi i Kuvendit - drejtor të thirret komisioni dhe të korrigjohet Rregullorja në bazë të këtyre vërejtjeve, që mos të kemi problem me këtë Rregullore pas një viti.

Hedh në votim, Kush është për:

Projekt Rregullores për ndarjen e bursave Miratohet unanim me këto vërejtje

Të gjithë anëtarët prezent në mbledhje.

Vendimet:

Pasi që vërejte dhe diskutime të tjera, nuk patë KPF -ja unanim miraton Projekt Rregullores për ndarjen e bursave, dhe të njëjtën ua dërgon Kuvendit të Komunës për Shqyrtim dhe Miratim.

Personat përgjegjës për zbatim: Shërbimi për punë të kuvendit

Afati për zbatim: Deri në mbledhjen e kuvendit

Shqyrtimi i pikës 3.

Kryesuesi i Kuvendit, vazhdojmë me pikën e tretë të rendit të ditës Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës së KRM "Ambienti" njësi operative Istog, për ngritjen e çmimit të shërbimit të grumbullimit, transportit dhe deponimit të mbeturinave.

Kryetari i Komunës – përshëndet të gjithë të pranishmit, prezanton dhe sqaron Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës së KRM "Ambienti" njësi operative Istog, për ngritjen e çmimit të shërbimit të grumbullimit, transportit dhe deponimit të mbeturinave.

Menaxheri i KRM Ambienti z. Alfred Tahirsylaj - përshëndet të gjithë të pranishmit, sqaron nevojat rreth ngritje së tarifës nga 5 euro në 6 për shërbimin e amvisnis.

Ajshe Metaj - ju e thatë se kjo kompani funksionon dhe punon mirë dhe u tha se i kanë 8 mijë euro borxh, u tha që kompanisë i kanë borxhe dhe për me i nxjerr atë borxh kompania duhet të angazhohet që të mos ketë vështirësi, po ashtu keni plotësisht të drejtë që janë rritur çmimet e të gjitha shërbimeve por nga ana tjetër duhet të shikohet edhe qytetari, sepse po i vështirësohet jeta nuk po flas për veten por ka njerëz që nuk e ka edhe një euro prandaj edhe unë nuk jam që të rritet tarifa.

Alferd Tahirsylaj- kjo rritje nuk është për biznese por vetëm për amvisëri, sepse bizneset e kanë me udhëzim tarifën e përcaktuar. Nëse nuk bëhet kjo rritje pas 2 apo 3 muaj duhet ta ndalojmë shërbimin krejt.

Niman Beqiraj - kemi fjalë të mira për punën në kompani por jo çdo herë duhet me u pajtuar rritja për 1 euro nuk është ndonjë rritje e madhe, mirë po nuk po e kuptoj pse duhet të bëhet kjo rritje, ku 84 mijë euro ka pas fitim vitin e kaluar nga janari deri në dhjetor e 8 mijë euro është plus në

gjashtëmujorin e parë atëherë kompania e Ambientit nuk është kompani e cila duhet të gjeneroj fitim, por duhet të jap shërbim. Ju jeni me sukses duke operuar, tri shtyllat kryesore siç i kini quajtur ju është : pagat e punëtorëve, karburanti dhe mirë mbajtjen, pagat e punëtorëve nuk kanë ndryshuar diçka siç kanë qene nëse ka ndonjë sqarim tjetër këtu nuk e kam parë mirë po të karburantet ka pas rritje, por jeni në fitim, sipas kësaj që po shihet nuk është e nevojshme me bë shtrenjtim të shërbimit. Është e pa nevojshme të ju rritet barra qytetarëve qoftë edhe për 1 euro.

Hajrush Shoshi - ne të gjithë po i shohim shtrenjtimit që janë duke u bërë, ngritja e çmimeve, karburanti. Të gjitha këto shtrenjtimi i kanë edhe qytetaret, mirë po që të kemi një ambient me të pasur jemi të detyruar që ta paguajmë edhe nga një euro me shumë ta ngrisim këtë çmim jam pro ngritjes se tarifës për Ambientin.

Faruk Kabashi - përshëndet të gjithë të pranishmit, nuk po e shohë të arsyeshme këtë shtrenjtim të shërbimit ku në gjashtë mujorin e parë jemi me plus 8 mijë dhe 16 mijë të pa inkasuara ku i bën 24 mije plus kemi shpenzime në gjashtëmujorin e parë që kanë ndodh por që nuk kanë me ndodh më janë blerë disa pajisje për punën e administratës një printer, regjistrimet e automjeteve qe një here ne vit regjistrohen ngitja prej 20% po me duket jo reale janë faturuar për 6muaj 34mijë e 668 , për një vite 69mijë për çka po i nevojiten kompanisë të gjitha këto. Mu po me del kështu.

Liridona Lajqi - përshëndet të gjithë të pranishmit, për shkak që kompania funksionon shumë mirë dhe është për çdo lëvdatë e shohë shumë të arsyeshme këtë ngritje çmimit për shkak të vështirësive që mund ti hasë për shkak të ngritjes së çmimeve, jam pro ngritjes së çmimit pasi që një euro nuk është edhe shumë e lartë.

Alferd Tahirsylaj - po ti bëjmë krahasimet për muaj vetëm të nafta kemi shpenzime të dukshme. 60 % e automjeteve janë të viti 2000 - 98 e përpjetë me ato është problem me funksiono më 8 mijë euro plus nuk ka shanca më ble një automjet.

Kryesuesi i Kuvendit - kjo do të jetë një mbijetesë për Ambientin.

Niam Beqiraj - jam duke folur në bazë të analizave që i kemi përpara, KRM Ambienti është që të i jap shërbim qytetarit dhe jo të prodhoj fitim. Vitin e kaluar ka pasur 84 mijë euro plus edhe këtë vit nëse fillon me këtë trend do të jetë kogja i përafërt me të viti të kaluar. Nuk mund ti krahasojmë suksese e kompanive, stacioni i autobusëve ka dështua sepse as një autobus nuk hynë aty brenda. Karburantet janë rritur edhe nëse i kanë kaluar rritjes që ka qen me herët tani ka zbritje dhe nuk është aq në krizë.

Kryetari i Komunës - nuk jam kundër me i ndihmuar Ambientit çka subvencionohet janë taksa të qytetarëve jo pare tonat. Ambienti do të jetë kompani komunale së shpejti, të çdo shtëpi 4 here ne muaj vjen kamioni i ambientit për kryerjen e shërbimeve.

Abedin Kabashi - kërkesën qe e ka bere menaxheri i ndërmarrje, kam menduar që nuk do të na del kaq shumë problem kam menduar që do të mirë kuptohet dhe të kaloj, duke marr parasysh shërbimin e tyre, nëse ne nuk i përkrahim tani shumë shpejt duhet ti subvencionojmë. Kam takime edhe me qytetaret të cilët janë që të shtohet edhe një euro. Kërkoj qe ta përkrahni. (Sqaron punën e

ndërmarrjes Ambienti dhe të punëtoreve aty).

Niam Beqiraj - po e kuptoj drejtorin ne duam me i përkrah punëtorët, a ju ka rrit rroga këtyre ndonjëherë. A ju rritet rroga këtyre e këtë ngritje a mundeni me na tregu.

Kryesuesi i Kuvendit - po ju ka rritë dhe do tju rritet.

Faruk Kabashi - Krejt në rregull Abedin po qeto që po i thua ti është dashur të jenë te shkruara që ne ti kemi.

Niman Beqiraj - krejt këto çka po fliten është dashur ti kemi ne përpara me një raport.

Kryetari i Komunës - plotësisht kini të drejt, (sqaron se çka mund të menaxhohet me ngritjen e tarifës zgjerimin e shërbimit) Alfredi dhe Abedini do ta përgatisin një raport për Kuvend që do të sqarohen të gjitha aty.

Niman Beqiraj - ta lemë për muajin tjetër këtë kërkesë edhe drejtori ta përgatis materialin sepse ne nuk mund ta votojmë kështu.

Kryetari i Komunës - dërgone në kuvend me kërkesën që të plotësohet me një raport sqarues për të gjithë anëtarët e Kuvendit.

Ardita Idrizaj - përshëndet të gjithë të pranishmit, i përkrahi kolegët që në mbledhjen e kuvendit me na pru një raport që të sqarohen këto problematik. Jam pro ngritjes së tarifës.

Kryesuesi i Kuvendit – pasi që diskutime tjera nuk ka, hedh në miratim
Miratohet me shumicë votash 6 vota për dhe 1 kundër,
Gjashtë anëtar prezent.

Diskutimet:

Vendimet:

Pasi që vërejte dhe diskutime të tjera, nuk pati KPF -ja me shumicë votash miraton kërkesa e KRM "Ambienti" njësia operative Istog, për ngritjen e çmimit të shërbimit të grumbullimit, transportit dhe deponimit të mbeturinave, dhe e njëjta i dërgohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Personat përgjegjës për zbatim:	Shërbimi për punë të kuvendit
Afati për zbatim:	Deri në mbledhjen e kuvendit

Shqyrtimi i pikës 4.

Diskutimet:

Kryesuesi i Kuvendit, po vazhdojmë më pikën e katërt të rendit të ditës, Shqyrtimi dhe miratimi i Draft Buxhetit për vitin 2023-2025.

Zyrtari Kryesor Financiar z. Osmon Sadikaj – përshëndet të gjithë të pranishmit, prezanton dhe sqaron Draft Buxhetit për vitin 2023-2025.

Hajrush Shoahi - jemi në fund të përpilimit të buxhetit ka filluar që nga Prilli kur ka ardh korniza e parë, të gjithë kemi vërejtje, personalisht kam pasur një propozim një projekt faza dytë nga burimi deri të trofta me e shty pak këtë projekt, sepse rruga e Dubravës është një rrugë mbi 2 kilometra dhe ne komunën tonë është rruga me e gjatë e pa asfaltuar, Dubravë - Kovragë. Në list pa buxhet është

Drejtori për Buxhet e Financa, z. Genc Ademaj - sqaron rreth këtij projekti.

Hajrush Shoshi - kjo rrugë ish urgjente as një interes nuk e ka aty por ish shumë në gjendje të keqe, për vitin 2023-24 duhet të kryehut.

Osmon Sadikaj, ZKF - të shikojmë me bashkëfinancim apo të jetë ndonjë projekt donacion, është të burimet tjera të financimit, ta shohim si mund të bëhet është projekt me prioritet.

Ardita Idrizaj - këtu të është 2 here ndërtimi i trotuarit Vrell - Lubozhdë a është gabim apo pse është dy here ky projekt me çmimin e njëjte.

Kanalizimi në Lubozhdë a është e përfshire edhe pjesa nalt të shtëpitë edhe rruga Ledinat as ajo pjesë nuk ka kanalizim, a janë të përfshira këtu

Osman Sadikaj, ZKF - po janë të përfshira të gjitha.

Kryetari i Komunës - këto projekte shumica janë nga dëgjimet publike që i kemi mbajtur nëpër bashkësi lokale të cilat i kemi mbajtur në prezencë të qytetarëve pa dallime politike, janë propozuar projektet të cilat qytetaret i kanë parë të nevojshme për rrethin ku jetojnë.

Kryesuesi i Kuvendit – pasi që diskutime apo propozime tjera nuk ka,

Hedh në miratim:

Miratohet unanim nga anëtarët e KPF-së.

Të gjithë anëtarët prezent.

Vendimet:

Pasi që vërejte dhe diskutime të tjera, nuk pati KPF -ja unanim, ai kalon kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim Draft Buxhetit për vitin 2023-2025

Personat përgjegjës për zbatim: Shërbimi për punë të kuvendit

Afati për zbatim: Deri në mbledhjen e kuvendit

Shqyrtimi i pikës 5.

Kryesuesi i Kuvendit, vazhdojmë më pikën e pestë të rendit të ditës, Miratimi i Transferit të mjeteve buxhetore të mbetura për bartje nga Kategoria Ekonomike 38-Rezerva në Kategorinë Ekonomike,30-Shpenzime Kapitale në shumë prej-400,000.00€.

Zyrtari Kryesor Financiar z. Osmon Sadikaj – bene prezantimin dhe sqarimin e Transferit të mjeteve buxhetore të mbetura për bartje nga Kategoria Ekonomike 38-Rezerva në Kategorinë Ekonomike,30-Shpenzime Kapitale në shumë prej-400,000.00€.

Ajshe Metaj – a është i sigurt që është bere ndërprerja e ekzekutimit të mjeteve nga thesar, dhe çka nëse nuk i merr nga pagat dhe mëditjet.

Niman Beqiraj – ne një here e kemi votuar këtë 400 mijë euro, ato projekte që e kemi pas zvogëluar atëherë ato para të njëjtat me i kthye edhe me u rregulluar .

Osmon Sadikaj – me siguri jemi keqkuptuar Niman kanë qene 1miljon e 600mijë prej tyre 1 milion e 200 mijë, ato projekte kanë përfunduar dhe janë alokuar paratë, ato janë duke u shpenzuar.

Kryesuesi i Kuvendit – A ka edhe dikush diçka?

Pasi që nuk ka diskutime tjera, hedh në votim

Miratohet me 6 vota për dhe 1 kundër nga anëtarët e KPF-së.

Të gjithë anëtarët e KPF-së prezent

Diskutimet:

Vendimet:

Pasi që nuk pati vërejte dhe diskutime tjera, KPF-ja me shumicë votash rekomandon që Transferi i mjeteve buxhetore të mbetura për bartje nga Kategoria Ekonomike 38-Rezerva në Kategorinë Ekonomike,30-Shpenzime Kapitale në shumë prej-400,000.00€, t'ia kalohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Personat përgjegjës për zbatim:

Shërbimi për punë të kuvendit

Afati për zbatim:

Deri në mbledhjen e kuvendit

Shqyrtimi i pikës 6.

Kryesuesi i Kuvendit, vazhdojmë më pikën e gjashtë të rendit të ditës, Shqyrtimi dhe Miratimi i projektit të ri kapital në bashkëfinancim me komunitetin për projektin “Ndërtimi I rrugëve në lagjen Osmanaj në Prekallë dhe Lagjen Blakaj në Llukavc të Begut” në vlerë prej 14,000.00 euro pjesa.

Zyrtari Kryesor Financiar z. Osmon Sadikaj - bene prezantimin dhe sqarimin e Projektit të ri kapital në bashkëfinancim me komunitetin për projektin “Ndërtimi I rrugëve në lagjen Osmanaj në Prekallë dhe Lagjen Blakaj në Llukavc të Begut” në vlerë prej 14,000.00 euro.

Ajshe Metaj – nese nuk ka implikime ligjore jemi për, pse jo.

Kryesuesi i Kuvendit – pasi që diskutime tjera nuk ka.

Hedh në votim miratohet unanim nga anëtarët e KPF-së.

Të gjithë anëtarët e KPF-së prezent.

Vendimet:

Pasi që nuk pati vërejte dhe diskutime, KPF-ja rekomandon që: Projekti i ri kapital në bashkëfinancim me komunitetin për projektin “Ndërtimi I rrugëve në lagjen Osmanaj në Prekallë dhe Lagjen Blakaj në Llukavc të Begut” në vlerë prej 14,000.00 euro pjesa dhe e njëjta i kalohet Kuvendit të Komunës për shqyrtim dhe miratim.

Personat përgjegjës për zbatim:

Shërbimi për punë të kuvendit

Afati për zbatim:

Deri në mbledhjen e kuvendit

Shqyrtimi i pikës 7

Diskutimet:

Kryesuesi i Kuvendit, po vazhdojmë më pikën e shtatë e rendit të ditës, Shqyrtimi dhe miratimi i Bartjes së mjeteve buxhetore të mbetura në vlerë prej: 12,987.00 €, nga viti 2019, 2020 nga të hyrat vetanake të pa shpenzuara në vitin 2022.

Zyrtari Kryesor Financiar z. Osmon Sadikaj - bene prezantimin dhe sqarimin e Shqyrtimi dhe miratimi i Bartjes së mjeteve buxhetore të mbetura në vlerë prej: 12,987.00 €, nga viti 2019, 2020 nga të hyrat vetanake të pa shpenzuara në vitin 2022.

Kryesuesi i Kuvendit- pasi qe diskutime nuk ka, a jeni qe kjo pikë ti shkoj Kuvendit Hedh në miratim

Miratohet unanim nga anëtarët e KPF-së.

Të gjith anëtarët e KPF-së prezent.

Vendimet:

Pasi që vërejte dhe diskutime të tjera, nuk pati KPF -ja unanim, ai kalon Kuvendit të Komunës Propozim - Vendimit për Destinimi e pronës së komunës për banim Social.

Personat përgjegjës për zbatim: Shërbimi për punë të kuvendit

Afati për zbatim: Deri në mbledhjen e kuvendit

Shqyrtimi i pikës 8

Diskutimet:

Kryesuesi i Kuvendit, po vazhdojmë më pikën e tetë të rendit të ditës Shqyrtimi dhe miratimi i Propozim - Vendimit për destinimin e pronave të paluajtshme të komunës për aktivitete sportive

Drejtori për Kadaster dhe Gjeodezi, z. Agon Dreshaj – përshëndet të gjithë të pranishmit, bene prezantimin dhe sqarimin Propozim - Vendimin për destinimin e pronave të paluajtshme të komunës për aktivitete sportive.

Kryetari i Komunës – sqaron rreth idesë së destinimit të pronës së komunës për dhënien në shfrytëzim.

Ajshe Metaj – a keni pasur edhe ndonjë kërkesë tjetër për dhënien e pronave komunale me qëllim të aktiviteteve sportive në Banjë e përkrahi sportin por në Banjë ka nevojë sepse nuk ka as një fushë për aktivitete sportive, ka kërkesa dhe nga ana e investitorve të jashtëm ka vullnet të mirë që të ipen mjetet.

Kryesuesi i Kuvendit z. Enver Rugova – pasi qe diskutime tjera nuk ka, a jeni qe kjo pikë ti shkoj Kuvendit

Miratohet unanim nga anëtarët e KPF-së.

Vendimet:

Pasi që vërejte dhe diskutime të tjera, nuk pati KPF -ja unanim, ai kalon Kuvendit të Komunës Marrëveshjen me Drinin e Bardhë për pastrimin sezonal të kanaleve të ujitjes – kullimi i tokave bujqësore.

Personat përgjegjës për zbatim: Shërbimi për punë të kuvendit

Afati për zbatim:	Deri në mbledhjen e kuvendit
Shqyrtimi i pikës 9	
Diskutimet:	
Kryesuesi i Kuvendit, po vazhdojmë më pikën e nënt të rendit të ditës Ndërrimi i emrit të projektit “Drenazhimi i fushës së sportit Demush Mavraj” me emrin e ri të projektit “Ndërtimi i Murit Rrethues të Stadiumit Demush Maraj”. Zyrtari Kryesor Financiar z. Osmon Sadikaj – benë prezantimin dhe sqarimin e Ndërrimit të emrit të projektit “Drenazhimi i fushës së sportit “Demush Mavraj” me emrin e ri të projektit “Ndërtimi i Murit Rrethues të Stadiumit Demush Maraj”. Niman Beqiraj – drenazhimi nuk nënkupton vetëm ndërtimin e një muri nëse nuk ka diçka tjetër por është vetëm këtu problemi ne e votojmë. Kryesuesi i Kuvendit – pasi qe diskutime tjera nuk ka, a jeni qe kjo pikë ti shkoj Kuvendit Miratohet unanimit nga anëtarët e KPF-së.	
Vendimet:	
Pasi që vërejte dhe diskutime të tjera, nuk pati KPF –ja unanimit, ai kalon Kuvendit të Komunës Marrëveshjen me ISEE – HSP për Fuqizimin e personave me aftësi të kufizuar.	
Personat përgjegjës për zbatim:	Shërbimi për punë të kuvendit
Afati për zbatim:	Deri në mbledhjen e kuvendit
Verejtje :	
Kryesuesi i kuvendit, pasi që përfunduan pikat për këtë rend dite, falënderoj për pjesëmarrje dhe kontributin e dhënë. Shpalli të mbyllura punimet për këtë mbledhje.	
Mbledhja përfundoj :	16:20

Procesmbajtëse,
Znj. Vjosa Hysenaj



Kryesuesi i Kuvendit,
z.Enver Rugova


